



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

Legjislatura VI  
Sesioni pranveror

---

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike  
Mbledhja nr. 40  
Prishtinë, më 25.2.2019, në orën 13:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

**P r o c e s v e r b a l**

**Në mbledhje morën pjesë:** Vjosa Osmani-Sadriu, Time Kadrijaj, Glauk Konjufca, Fitore Pacolli, Dukagjin Gorani, Doruntinë Maloku-Kastrati, Elmi Reçica, Evgjëni Thaçi-Dragusha dhe Zafir Berisha.

**Mungoi:** Danush Ademi dhe Sergjan Mitroviq.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Albulena Haxhiu, deputete; Yllka Gashi, Klarisa Nuredini, praktikante GP-LDK; Blerta Bejtullahu EUSR/EU Office, Violeta Haxholli, Eugen Cakolli, Loren Hyseni, KDI; Sanije Berisha OSBE; Butrint Berisha, PIPS; Hajrudin Skender, Swiss Embassy; Vlora Nushi, Katerina Limenopoulou OPA/UNMIK; Adem Gashi, Ambasada Amerikane; Shpresë Sejdiu, PSD; Blerim Sallahu, LVV; Avdi Morina, Zyra e Zv. Kryeministrit Limaj; Dardan Berisha, Alban Krasniqi ZKM-USAID; Naim Jakaj, Kuvend dhe media.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

**Mbledhjen e kryesoi:** Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 12 shkurt 2019;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-145 për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë.
4. Shqyrtimi Platformës për dialogun mbi Marrëveshjen përfundimtare, gjithëpërfshirëse dhe ligjërisht të detyrueshme për normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë;
5. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

**Doruntinë Maloku- Kastrati**, propozoi që pika 4 e rendit të ditës që hiqet nga shqyrtimi pasi që nuk i ka plotësuar kushtet formale-juridike për t'u trajtuar në komision. Ajo më tej tha se Projektligji për dialogun, i cili i jep kompetenca delegacionit shtetëror për ta sjellë platformën në Kuvend nuk është miratuar në Kuvend.

**Vjosa Osmani -Sadriu**, tha se pajtohet me vlerësimin e deputetes Maloku dhe kërkoi pajtimin e anëtarëve të komisionit që ta informojë Kryesinë e Kuvendit që shkak i nenit 9 të Projektligjit për dialogun, komisioni mund ta shqyrtojë Platformën, e cila derivon nga një ekip, i cili formohet vetëm pas miratimit të ligjit.

**Elmi Reçica**, shprehu mendimin se delegacioni është votuar në Kuvend dhe se është legjitim, pavarësisht se çfarë ndodh me ligjin. Ai më tej shtoi se nëse ekziston bindja se do të duhej të shtyhet shqyrtimi i Platformës gjersa të votohet ligji, atëherë kjo mund të bëhet, por meqë delegacioni është votuar dhe i ka marrë votat e mjaftueshme ai delegacion është legjitim.

**Doruntinë Maloku- Kastrati**, njoftoi se më 15 dhjetor 2018 është votuar në Kuvend një rezolutë e cila në të kishte edhe ekipin e delegacionit shtetëror. Rezoluta rrjedhimisht nuk është akt i detyrueshëm ligjor, prandaj gjithçka që derivon nga ai ekip është antiligjor dhe antikushtetues.

**Vjosa Osmani- Sadriu** tha se vetë delegacioni shtetëror dhe partitë që e kanë përkrahë delegacionin shtetëror janë përcaktuar që mandati i delegacioni të bëhet me ligj. Sa i përket ligjit shprehu mendimin se është një ligj i panevojshëm, dhe se udhëheqja e dialogut duhet të bëhet nga Qeveria si i vetmi institucion që ka kompetencë të tillë kushtetuese. Ajo shtoi se së pari ligji duhet të hyj në fuqi, pasi që përcakton përbërjen e delegacionit shtetëror dhe çështje tjera në mënyrë që t'i jepet legalitet këtij procesi, pastaj duhet të vijë platforma.

**Elmi Reçica** tha se mund të renditet për shqyrtim së pari ligji, pastaj platforma, në mënyrë që të kalojë së pari ligji, por gjersa nuk votohen në seancë plenare çdo dokument është ende në zhvillim e sipër.

**Doruntinë Maloku -Kastrati** tha se Projektligji për dialogun ia jep kompetencat delegacionit shtetëror që ta sjellë Platformën në Kuvend, rrjedhimisht ligji nuk është miratuar dhe si rrjedhojë delegacioni shtetëror ende nuk i ka këto kompetenca. Ajo më tej shtoi se gjithçka që ka ndodhur ndërmjet rezolutës së 15 dhjetorit deri sot është joligjore. Maloku tha se është e turpshme se si Kryetari i Kuvendit mundohet ta vejë në lajthitje komisionin për ta sjellë një dokument, një platformë me kaq rëndësi në mënyrë jashtëligjore.

**Time Kadrija** tha se komisioni gjatë amendamentimit mund ta rregullojë projektligjin në mënyrë që të përputhet edhe me platformën dhe se nuk ka asnjë të keqe që të trajtohet së pari projektligji pastaj edhe platforma, e cila duhet të shkojë edhe në seancën e Kuvendit. Shprehu mendimin se platforma duhet të trajtohet dhe të procedohet në seancë plenare.

**Glauk Konjufca** tha se pajtohet me deputeten Maloku, sepse ky është një paradoks për të cilin përgjegjësinë e marrin ata që janë kurthuar në këto procedura që i kanë ngritur vetë për shkak që njëri prej neneve të atij ligji thotë që ekipi shtetëror e sjell platformën. Ai shtoi se këtë kanë dashur ta bëjnë përmes obligimit ligjor, e ligji ende nuk ka hyrë në fuqi dhe se ky paradoks nuk i bënë nder Kuvendit të Kosovës që të vazhdojë me këtë kundërthënie vetëm pse i kanë votat.

**Albulena Haxhiu**, njoftoi se është e pranishme në këtë mbledhje për çështjen të cilën e ngriti deputetja Maloku. Ajo tha se projektligj ka nene që bien ndesh me Kushtetutën, gjegjësisht nenin 18 të Kushtetutës dhe se nuk e kupton ngutinë se pse po shkelen rregullat për të cilat janë zotuar se do të respektohen. Ajo po ashtu njoftoi se edhe nëse komisioni e procedon projektligjin për shqyrtim të dytë në seancë plenare, është edhe afati 8 ditor kur dikush mund ta kontestojë një projektligj në Gjykatën Kushtetuese. Haxhiu theksoi se propozimi i deputetes Maloku është i drejtë, prandaj edhe anëtarët e komisionit do të duhej ta mbështesnin.

**Elmi Reçica** tha se paradoksi më i madh është se dialogu po vazhdon, kurse ne po kërkojmë të nxjerrim dokumente të këtij Kuvendi, si ligjin ashtu edhe platformën dhe tash po del e kundërta, që ju nuk jeni të interesuar që të nxjerrën këto dokumente dhe të vazhdojë dialogu.

**Vjosa Osmani -Sadriu**, tha se është paradoks të nxirren dokumente të cilat lejojnë hapur që të negociohet statusi edhe territori i Kosovës. Duke iu referuar deputetit Reçica tha se sikur të ishte ashtu siç po thoni ju ne nuk do të insistonim që në përputhje me Kushtetutën dialogun ta udhëheq Qeveria. Sa i përket platformës tha se kemi një platformë e cila lë hapur mundësinë e negocimit të territorit, sepse negocimi nuk parandalohet. Ajo më tej tha se paradoks është që në Kuvendin e Kosovës me deputetët shqiptarë duhet të diskutohet nëse po e mbrojmë ose jo statusin e Kosovës si shtet i pavarur edhe kufijtë e Kosovës, edhe a po ia ndalojmë dikujt apo jo të negociojë me territorin e Kosovës.

**Elmi Reçica** tha se në platformë thuhet qartë që shpallja e pavarësisë, njohja e pavarësisë nga GJND është e padiskutueshme dhe e pacenueshme. Ai po ashtu tha se edhe kjo platformë është e diskutueshme, e cila duhet të debatohet dhe në fund të votohet e të thuhet qartë se në të nuk ka negociim të territorit të Kosovës.

**Vjosa Osmani- Sadriu**, duke iu referuar parimit të 6 të platformës, tha se në momentin që mungon fjala i panegociushëm, kjo lë hapësirë që të bëhet temë e dialogut, kurse vendimi përfundimtar i mbetet Kuvendit. Nenit të Kushtetutës të cilit po i referohet platforma tha se më shumë i referohet mbrojtjes së territorit nga cenimi që ia bënë dikush nga jashtë, por nuk e mbron atë që të diskutohet nga institucionet për brenda. Jo rastësisht kjo platformë e ka lënë të hapur dhe askund nuk e përmend rolin e Presidentit të Republikës i cili për momentin është i vetmi që po negocion për territorin.

**Elmi Reçica** tha se do të duhej ta lexonim platformën nga pika e parë e cila thotë shumë qartë atë se si është shpallur dhe njohur pavarësia e Kosovës dhe se do të duhej që ky të jetë parimi bazë. Ai më tej shtoi se nuk duhet të futemi në spekulime se kush është duke biseduar, pasi që nuk kemi ndonjë informacion. Reçica tha se ligji, platforma dhe delegacioni shtetëror janë konform asaj që tërësia territoriale e Kosovës është e paprekur dhe nuk negociohet. Shprehu mendimin se platforma është një dokument që do të duhej të trajtohet sa më shpejt dhe se projektligji do të duhej sa më shpejt të miratohet.

**Vjosa Osmani- Sadriu** tha se është e vërtetë që parimi i parë flet për njohjen e ndërsjellë, por nuk e përmend njohjen në cilët kufij. Parimi 1 ka për qëllim që të sigurohet njohja dhe pranimi i qartë i sovranitetit si shtet i pavarur, me zotime ligjërish të detyrueshme, por askund nuk flet se në cilët kufij.

**Elmi Reçica** tha se deklarata e pavarësisë nënkupton që në këtë territor që është aktualisht, është shpallur pavarësia e Kosovës. Është shumë e qartë që flitet për atë territor në bazë të cilit është shpallë pavarësia e Kosovës dhe është njohur nga GJND.

**Doruntinë Maloku- Kastrati** tha se po i vjen mirë që paska bërë një hap përpara drejtë afirmimitit me qëndrimet e opozitës deputeti Reçica e jo me qëndrimet e Hashim Thaçit, sepse deklarativisht po flet atë që e kemi thënë ne, ndërsa platforma thotë diçka tjetër.

**Elmi Reçica** njoftoj se qëndrimet politike të qarta të Kryesisë së partisë, të Këshillit Drejtues dhe të gjitha organeve përcjellëse janë këto të cilat i tha dhe që i ka thënë vazhdimisht.

Pas diskutimeve kryetarja konstatoi se komisioni nxori këtë

*Përfundim*

*Propozimi i deputetes Doruntinë Maloku Kastrati për heqjen e pikës 4 nga rendi i ditës nuk u miratua nga anëtarët e komisionit me 4 vota “për” dhe 5 vota “kundër”.*

*Rend i ditës u miratua me 5 vota “për” dhe 4 vota “kundër”.*

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 12 shkurt 2019**

Kryetarja konstatoi se komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 12 shkurt 2019.

## **3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-145 për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë**

**Vjosa Osmani- Sadriu** njoftoi se projektligji është miratuar në parim më 2 shkurt 2019 dhe se vetëm deputeti Dukagjin Gorani i ka propozuar dy amendamente në projektligj:

### Amendamenti 1

Në nenin 5, paragrafi 1, fjala “njëmbëdhjetë” ndryshohet në fjalën “dymbëdhjetë”.

Për këtë amendament 5 vota ishin “për”, kurse nuk u hodh në votim se kush është “kundër” dhe kush “abstenon” nga deputetët e pranishëm në takim.

### Amendamenti 2

Në nenin 13, paragrafi 3, fjalët në fund “të pranishëm” të hiqen dhe të shtohen fjalët “të delegacionit”.

Për këtë amendament 5 vota ishin “për”, kurse nuk u hodh në votim se kush është “kundër” dhe kush “abstenon” nga deputetët e pranishëm në takim.

Pas diskutimeve kryetarja konstatoi se komisioni nxori këtë

### *Përfundim*

Miratohet raporti me rekomandime për Projektligjin nr. 06/L-145 për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë me 5 vota “për” dhe 4 vota “kundër”.

**Vjosa Osmani- Sadriu** tha se do ta kërkojë një vlerësim nga zyra ligjore e Kuvendit nëse sipas procesit të votimit të amendamenteve, ato janë miratuar apo jo.

## **4. Shqyrtimi Platformës për dialogun mbi Marrëveshjen përfundimtare, gjithëpërfshirëse dhe ligjërish të detyrueshme për normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë.**

**Dukagjin Gorani** tha se inkurajon komisionin që ta përkrahë dhe ta votojë këtë dokument, i cili është prodhim i një kompromisi brenda delegacionit shtetëror. Para deputetëve tha se është një dokument, produkt i një pune disa javore dhe jo të lehtë që paraqet një tërësi të ndërtuar mbi arsyeshmëri. Kërkoj që të mos ndryshohet platforma e propozuar meqenëse me atë ndikohet baraspesha përmbajtjesore dhe programore e dokumentit.

**Vjosa Osmani- Sadriu** tha se sa i përket përmbajtjes së platformës, njoftoi se delegacioni shtetëror pranon jo vetëm marrëveshjen e prillit të viti 2013 me të cilën është krijuar Asociacioni komunave serbe, por i pranon edhe të gjitha marrëveshjet e tjera të cilat janë arritur gjatë këtij procesi 6-7 vjeçar, përfshirë edhe marrëveshje për të cilat ka vendime të Gjykatës Kushtetuese.

Duke iu referuar platformës tha se në pikën 2 thuhet se pranohet marrëveshja e parë e cila në të gjitha pikat e para e krijon Asociacionin e komunave serbe, dhe se nuk do të ketë qeverisje të nivelit të tretë. Pra, platforma në një mënyrë tenton kinse ta refuzojë te parimi 7 Asociacionin e komunave serbe, përderisa në hyrje pozicionohet të pranojë të gjitha marrëveshjet e nënshkruara përfshirë atë që e ka themeluar Asociacionin e komunave serbe.

Duke iu referuar parimit 2, pikës c, ku kërkohet nga Serbia që të heqë dorë nga kundërshtimi ose ndikimi mbi palët e treta për anëtarësim në organizata ndërkombëtare, përfshirë Kombet e Bashkuara, Bashkimin Evropian, Këshillin e Evropës, OSBE dhe agjencitë e tyre, tha se në këtë mënyrë delegacioni shtetëror përcaktohet që Kosova mos të aplikojë në këto organizata pa ndodhur marrëveshja me Serbinë. Futja e KE-së në këtë listë tha se është një gabim i madh, sepse programi i Qeverisë që është votuar në Kuvend e ka aplikimin për KE prioritet të parë të politikës së jashtme. Te parimi i 4 thuhet që objektivë e Kosovës është që në procesin e dialogut të shqyrtojë të gjitha çështjet e hapura me Republikën e Serbisë. Ky formulim tha se është jashtëzakonisht problematik, sepse për Serbinë çështje e hapur është sovraniteti i Kosovës, statusi i Kosovës, pronat e Kosovës, territori i Kosovës, dhe nëse ne pranojmë që të gjitha çështjet e hapura në mes të Kosovës dhe Serbisë të negociohen atëherë automatikisht po pranojmë që të futën në agjendë dhe të vendosen në tavolinën e negociatave këto çështje.

Po ashtu te parimi 4, pika d, tha se krimeve që janë kryer në Kosovë platforma iu referohet vetëm si krime të luftës duke hequr kështu dorë nga qëndrimi i deritanishëm zyrtar i Republikës së Kosovës, që në Kosovë, përveç krimeve të luftës janë kryer edhe gjenocid dhe krime kundër njerëzimit. Referimi që këtu i bëhet të drejtës humanitare është vetëm shkelje e 4 konventave të Gjenevës dhe disa të tjera, por që ekskluzivisht kanë të bëjnë vetëm me krimet e luftës. Pra, këtu delegacioni shtetëror pozicionohet se kinse në Kosovë ka pasur vetëm krime të luftës, por jo krime kundër njerëzimit dhe jo gjenocid. Lidhur me këtë shprehu mendimin se ky është një gabim, pasi që e bllokoi Kosovën që në të ardhmen të fillojë rast për reparacion për gjenocid.

Lidhur me parimin 6 tha se është e pamjaftueshme që platforma t'i referohet nenit 2.2 të Kushtetutës, i cili thotë që integriteti i pacenueshëm, i patjetërsueshëm dhe i pandashëm, nga vetë gjuha që përdoret këtu dhe me faktin që mungon terminologjia i panegociushëm, lë hapësirë që kjo terminologji të na mbrojë nga sulmet e jashtme, por assesi nga hapja e kësaj teme, apo negocimi i kësaj teme. Pra, patjetër duhet të figurojë edhe terminologjia i panegociushëm nga ndonjë institucion shtetëror i Republikës së Kosovës, tha Osmani.

Ajo njoftoi se Presidenti nuk ka të drejtë të krijojë pozicione në dialogun Kosovë-Serbi, por vetëm t'i mbrojë ato pozicione që i krijon Qeveria dhe Parlamenti, kjo platformë e ka lënë këtë temë qëllimisht ose gabimisht të heshtur dhe se në këtë platformë nuk e trajtohet roli i institucioneve tjera shtetërore. Në parimin 7 tha se, thuhet që në Republikën e Kosovës nuk mund të ketë nivel tjetër të qeverisjes ku në mënyrë indirekte refuzohet asociacion, por kjo platformë pranon të gjitha marrëveshjet e nënshkruara përfshirë edhe marrëveshjen e vitit 2013 përmes së cilës është krijuar asociacioni. Pika 11.1 e cila flet për transparencën, bje në kundërshtim me projektligjin për dialogun, i cili kërkon që informatat të mbahen sekret zyrtar, ndërsa sa i përket parimit gjithëpërfshirës përbërja aktuale e delegacionit është në kundërshtim me këtë parim. Në pikën 11.3 lidhur me grupet e interesit që nuk përfaqësohen, tha se nuk e di se çfarë mekanizëm kontakti do të mund të krijohet, pasi që ai mekanizëm është i paraparë në Kushtetutë e që quhet mbikëqyrje parlamentare e që e bënë opozita për çdo proces përfshirë edhe atë të dialogut. Tek pika për Kosovën në kontekst ndërkombëtar ku pos tjerash thuhet se njohja e Kosovës nuk ka qenë universale znj. Osmani tha se përkundër ngecjeve numri i njohjeve është tepër i rëndësishëm dhe përveç që përfaqëson 2/3 e GNDP-së botërore kemi edhe 2/3 e demokracisë botërore. Te pika 9 për përfitimet e njohjes reciproke tha se anëtarësimi në Këshillin e Evropës lidhet drejtpërdrejt me arritjen e marrëveshjes, ndërsa pika 12 për krimet e luftës tha se përsëri këtu i referohet vetëm krimeve të luftës ndërkaq injorohet qëndrimi zyrtar për gjenocid

dhe krime të luftës për të cilat krime kryesisht ka folur Tribunali ndërkombëtar penal për ish - Jugosllavinë. Më pas në platformë thuhet se individët mund të kërkojnë kthimin e të mirave materiale e pensioneve, nëpërmjet një mekanizmi që do të krijohet, për të cilin znj. Osmani tha se ekziston Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut në të cilën disa qytetarë të Kosovës e kanë paditur Serbinë dhe i kanë fituar rastet. Kuvendi tha se e ka formuar një ekip që është dashur të funksionalizohet nga Qeveria në mënyrë që t'i ndihmojë pensionistëve rreth dokumentacionit për realizimin e pensioneve. Te pika 13 lidhur me suksesionet, sipas platformës kërkohet që gjithçka të kthehet nga zero përderisa qëndrimi zyrtar i Kosovës është që të aplikohet parimit të Badinterit që kanë vlejtur për të gjitha republikat e ish- Jugosllavisë dhe se po kontestohet argumenti i cili është thënë në GJND se Kosova ka qenë pjesë konstituive e Jugosllavisë. Pika 15 mbi suksesionin ndaj detyrimeve të traktateve ndërkombëtare tha se është në kundërshtim me pikën 9 të Deklaratës së pavarësisë dhe nenin 145 të Kushtetutës së Kosovës. Të dy këto nene parashohin që Kosova vazhdon t'i aplikojë të gjitha traktatet ndërkombëtare që kanë qenë të nënshkruara në emër të saj nga ish Jugosllavia dhe UNMIK-u. Lidhur me pikën 16, ku thuhet se marrëveshja do të përmbajë dispozita kornizë lidhur me shumë çështje teknike znj. Osmani tha se për shumë këto çështje ekzistojnë marrëveshje të cilat në hyrje të platformës u tha se pranohen në tërësi. Sipas kësaj pike këto marrëveshje ose pranohen ose fillohet nga zero lidhur me to.

Te pika 17 shfuqizimi i Rezolutës 1244 tha se në këtë pikë nuk ka kuptim sepse kjo ka përfunduar me shpalljen e pavarësisë më 2008 dhe kështu vijmë në kundërshtim me interpretimin që GJND i ka bërë Rezolutës 1244. Te pika 18 tha se, thuhet se BE e SHBA pritet të jenë garantuese të zbatimit të obligimeve, por historia ka dëshmuar që garancat politike nuk mjaftojnë dhe është e nevojshme të ketë edhe garanca të shumta juridike, ndërsa sa i përket zgjidhjeve të mosmarrëveshjeve në mes të arbitrazhit të detyrueshëm tha se është e nevojshme një platformë e mirëfilltë serioze që bën analiza të detajuara se çfarë është lloji i arbitrazhit, në çfarë periudhe kohore, në cilin arbitrazh dhe për cilat tema Kosova pranon të shkojnë arbitrazh. Te konkluzionet ku thuhet se Serbia duhet ta shfrytëzojë këtë mundësi që të pranojë realitetin aktual dhe nëse realiteti aktual është ai që përmendet në këtë dokument, pra që Kosova ka nevojë për njohjen nga Serbisë në mënyrë që të aplikojë në KE e në OKB atëherë ky është një realitet që nuk e ka Serbia aq vështirë me e pranuar, sepse i ndihmon në tavolinën e negociatave për ta fuqizuar pozicionin e vet. Ky dokument në përgjithësi tha se përveç që ka probleme të mëdha sepse injoron deklaratën e pavarësisë dhe Kushtetutën e Kosovës, nuk e mbron as territorin e saj, e as pavarësinë e shtetësinë e Kosovës.

**Glauk Konjufca** tha se këtë proces të dialogut duhet ta vlerësojmë edhe në aspektin politik. Si kusht i koalicionit qeverisës ka qenë parimi që kryeministri të heq dorë prej dialogut me Serbinë. Presidenti me marrjen e procesit të dialogut në duar dhe me projektin e tij ka hapur dhe ka vënë në pikëpyetje një proces i cili në Kosovë ka pas një konsensus të brendshëm sa i përket pozicionit tonë se si e në çfarë drejtimi e shohim Kosovën dhe si e konceptojmë mënyrën e shtet ndërtimit. Ai tha se President nga muaji qershor i ka dhënë një godite fatale këtij vizioni dhe në Kosovë që 8 muaj kemi një ndarje të brendshme fatkeqësisht që i ka shkaktuar shumë dëme procesit të shtet ndërtimit të Kosovës. Dy çështje për të cilat delegacioni shtetëror duhet t'i adresohet presidentit dhe t'i tregoj se nuk ka mandat për ta zhvilluar atë aktivitet tha se kanë të bëjnë me deklaratën e tij se kufiri me Kosovën e Serbinë do të jetë 430 km dhe çështja tjetër për të cilën në mënyrë eksplicite në tryezën me liderët e partive politike thotë se nëse nuk arrihet marrëveshja me Serbinë shumë shpejt do të destabilizohet rajoni. Në këtë drejtim tha se duhet pyetur Presidentin se çfarë informata ka ai të sakta për destabilizim të rajonit dhe pse ka pretendime të tilla. Sa i përket legjitimitetit të forcave në procesin e dialogut tha se presidenti është kriza e parë e legjitimitetit, ndërsa ajo e dyta është PSD që nuk përfaqëson idetë përmes të cilave i ka mbledhur votat. Kosova tha se ka nevojë vetëm për një platformë e ajo është se si me e ndal projektin e Presidentit. Ky tha se është një proces shumë i dyshimtë që Qeveria nuk është pozicionuar qartë ndaj presidentit. Propozon që kjo platformë të mos shkojë në fazat e mëtejme të shqyrtimit, e po ashtu as projektligji për dialogun pa pozicionim të qartë të qeverisë. Ai tha se gjithçka që Presidenti tejkalon kufijtë e definuar sipas Kushtetutës së Kosovës në politikën e jashtme, është jashtë mandatit të tij.

**Evgjeni Thaçi- Dragusha** duke u ndërlidhur me diskutimin e deputetit Glauk Konjufca e pyeti atë se a e ka njohur LVV Republikën e Kosovës, të cilën dëshirojnë ta mbrojnë aq shumë. Ajo më tej tha se si mund të mendoj LVV sikurse Serbia, përderisa shtoi se askush nga PDK nuk ka përmendur shkëmbimin e territoreve, e as ndarjen e Kosovës. Znj. Thaçi Dragusha pyeti se kush nga anëtarët e komisionit është kundër marrjes së Preshevës, Medvegjës e Bujanocit, brenda territorit të Kosovës.

**Glauk Konjufca** tha se e kanë njohur Republikën e Kosovës dhe atë janë duke e mbrojtur, çdo ditë. Nëse znj. Evgjeni Thaçi- Dragusha e përfaqëson këtu presidentin e vendit, tha se ai ka përdorur terme si kompromis i dhimbshëm, shkëmbim i territoreve dhe demarkacion para njohjes.

**Zafir Berisha** tha se edhe nëse këtë platformë e tërheqim nga tavolina dhe e vëmë një platformë tjetër, ne prapë do të kemi ide të mira për ta plotësuar sepse kemi qasje të ndryshme për problematika të caktuara. Platforma, por edhe ligji janë përpjekje për të cilat ne po mundohemi t'i japim kuptim institucioneve të Kosovës dhe shtetit të Kosovës në raport me Serbinë. Duke e pasur parasysh situatën në të cilën ndodhemi tha se shërbimi më i mirë për Kosovën është që forcat politike të jenë unike në interesat e Kosovës. Të gjithë ne që jemi në skenën politike duhet ta pranojmë se nga pak jemi fajtorë, për situatën në të cilën jemi, prandaj është mirë që të jemi unik sa nuk është vonë, tha Zafir Berisha. Lidhur me Platformën tha se ajo është një kornizë orientuese të cilën duhet ta kemi për bisedime e po ashtu theksoi se Presidenti nuk është duke bërë mirë me deklaratat e tij të cilat janë ose taktikë politike apo synime ë vërteta.

**Time Kadrijaj** lidhur me platformën tha se është mirë që në platformë është përfshirë respektimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe në parimin 6 se statusi i Kosovës është i pa negociueshëm, që është qëndrim i të gjitha subjekteve politike. Ne duhet ta mbrojmë Kosovën e 17 shkurtit e cila është njohur nga 115 shtete. Në parimin 6 lidhur me territorin e Kosovës tha se nuk ka asgjë të keqe, këto janë qëndrime të Qeverisë së Kosovës dhe të gjitha subjekteve politike.

**Elmi Reçica** tha se të gjithë jemi të vetëdijshëm se çfarë peshe dhe çfarë rëndësie ka dialogu me Serbinë dhe përmbyllja e kësaj çështjeje të hapur. Në këtë dialog me Serbinë tha se duhet të jemi të gjithë së bashku, edhe dy partitë më të fuqishme opozitare duhet të jenë pjesë e dialogut dhe finalizimit të tij. Ne, si deputetë, tha se duhet t'i përmbushim çështjet të cilat kërkohen nga ne dhe ta precizojmë e begatojmë këtë platformë me çështjet që u ngritën këtu. Z. Reçica tha se është shumë e rëndësishme që ne të ecim përpara dhe të mos lejojmë të cenohet ajo çka është interes i shtetit tonë.

Pas diskutimeve kryetarja konstatoi se komisioni nxori këtë

### *P ë r f u n d i m*

*Platforma për dialogun mbi Marrëveshjen përfundimtare, gjithëpërfshirëse dhe ligjërish e detyrueshme për normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për votim, në komisioni nuk kishte vendimmarrje.*

*Me rastin e votimit, 5 deputetë votuan për miratimin e platformës, asnjë deputet nuk votoi kundër dhe asnjë deputet nuk abstenoj, nga 9 deputetët e pranishëm me rastin e votimit.*

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

**Kryetarja e komisionit,**

**Vjosa Osmani-Sadriu**

**E përgatiti:  
Stafi mbështetës i komisionit.**